



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05  
**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatësi Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 10 shkurt 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të të akuzuarit**  
Julius von Bone

**Zyrës Administrative**  
Zyrës për Pjesëmarrjen e Viktimave

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenet 22(1), 39(1) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji) dhe me rregullat 95(2)(i) dhe 113 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), merr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më datë 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Salih Mustafës.<sup>2</sup> Më datë 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar parashtrio aktakuzën e konfirmuar ("Aktakuza e Konfirmuar").<sup>3</sup>

2. Më datë 27 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat ("Vendimi Kornizë"), ku, ndër të tjera, i jepte urdhër Zyrës për Pjesëmarrjen e Viktimave ("ZPV") t'u paraqiste brenda datës 10 dhjetor 2020 raportin e parë në pajtim me rregullën 113(2) të Rregullores, Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe palëve lidhur me kërkesat e dorëzuara dhe të paraqiste periodikisht raporte të mëtejshme, nëse do të kishte, , jo më vonë se dorëzimi i parashtrimit të Mbrojtjes në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores.<sup>4</sup>

3. Më datë 9 dhjetor 2020, ZPV-ja paraqiti raportin e saj të parë mbi kërkesat e ardhura ("raporti i parë") me katër shtojca rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të cilat përmbanin një përmbledhje të kërkesave dhe formularët e kërkesave të

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Një version i redaktuar publik u protokollua më datë 5 tetor 2020.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F00011/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, konfidenciale. Versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u protokollua më 28 shtator 2020: KSC-BC-2020-05, F00019/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojcë 1 e parashtrimit të versionit të redaktuar më tej të Aktakuzës së Konfirmuar*, 28 shtator 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-05, F00055, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat ("Vendimi Kornizë")*, 27 nëntor 2020, publik, para. 55(c)-(e).

gjithsej katër parashtruesve të kërkesave (“shtojcat”). ZPV-ja më tej i bënte të ditur Gjykatësit të Procedurës Paraprake se raporti i parë mund t’u bëhej i ditur palëve dhe publikut.<sup>5</sup>

## II. PARASHTRIMET

4. Sa i takon numrit të kërkesave dhe kohës dhe mënyrës së marrjes të tyre, ZPS-ja parashtron se, deri në datën e raportit të parë të saj, kishte marrë nëpërmjet postës elektronike katër kërkesa nga persona që kërkonin pranimin në proces si viktimë pjesëmarrëse.<sup>6</sup>

5. Sa i takon plotësisë së kërkesave, ZPV-ja parashtron se tre parashtrues të kërkesave nga e njëjta familje (viktimat 01/05, 02/05 dhe 03/05) nënshkruan dhe dorëzuan bashkërisht një formular kërkesë, të cilin ZPV-ja e regjistroi si tri kërkesa të veçanta.<sup>7</sup> Një parashtrues i katërt (viktima 04/05) dorëzoi dhe nënshkroi një formular kërkesë.<sup>8</sup> ZPV-ja më tej vëren se asnjë prej parashtruesve nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm përkatës<sup>9</sup> dhe se, pas vlerësimit të të gjitha kriterëve të pranimit, ZPV-ja nuk e konsideroi të nevojshme t’u kërkonte parashtruesve t’i plotësonin kërkesat dhe të paraqisnin dokumentacionin e nevojshëm mbështetës.<sup>10</sup>

6. Sa i takon pranueshmërisë së kërkesave, ZPV-ja i rekomandon Gjykatësit të Procedurës Paraprake t’i rrëzojë të katër kërkesat,<sup>11</sup> duke qenë se asnjëri prej

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, F00062, Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave, *Raporti i parë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces* (“Raporti i Parë”), 9 dhjetor 2020, publik, me shtojcat rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* 1-4 (“Shtojca 1”; “Shtojca 2”; “Shtojca 3”; “Shtojca 4”).

<sup>6</sup> Raporti i Parë, para. 5.

<sup>7</sup> Raporti i Parë, para. 11.

<sup>8</sup> Raporti i Parë, para. 11.

<sup>9</sup> Raporti i Parë, para. 11.

<sup>10</sup> Raporti i Parë, para. 12.

<sup>11</sup> Raporti i Parë, para. 27.

parashtruesve të kërkesave (i) nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton identitetin e vet dhe që vërteton se është person fizik;<sup>12</sup> dhe (ii) nuk ka përshkruar veprimet që duken se kanë lidhje me krimet që bien brenda kuadrit gjeografik dhe kohor të Aktakuzës së Konfirmuar.<sup>13</sup>

7. Sa u takon masave mbrojtëse, ZPV-ja parashtron se viktimat 01/05, 02/05 dhe 03/05 nuk kërkojnë masa të tilla, ndërsa viktima 04/05 kërkon që të dhënat identifikuese të mos bëhen publike.<sup>14</sup> Megjithatë, ZPV-ja kërkon që, për të ruajtur konfidencialitetin e procesit dhe për të mbrojtur privatësinë e parashtruesve të kërkesave,<sup>15</sup> të merren masat e mëposhtme: (i) të mbahen pseudonimet e të katër parashtruesve të kërkesave dhe klasifikimi rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* i shtojcave;<sup>16</sup> dhe, në çdo rast, (ii) emrat dhe çdo e dhënë identifikuese e parashtruesve të kërkesave të redaktohen nga dokumentacioni publik i Dhomave të Specializuara, në pajtim me rregullën 80(4)(a)(i) të Rregullores.<sup>17</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Në pajtim me nenin 22(1) të Ligjit dhe me rregullën 2 të Rregullores, viktima është personi fizik që ka pësuar dëm fizik, material apo mendor si pasojë e drejtpërdrejtë e një vepre penale që bie brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe që pretendohet në një aktakuzë të konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake.

9. Në pajtim me rregullën 113(1) të Rregullores, pas konfirmimit të aktakuzës dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes, një person që pretendon se është viktimë e një vepre penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për

---

<sup>12</sup> Raporti i Parë, para. 21.

<sup>13</sup> Raporti i Parë, para. 23, 26.

<sup>14</sup> Raporti i Parë, para. 28.

<sup>15</sup> Raporti i Parë, para 29.

<sup>16</sup> Raporti i Parë, para. 29.

<sup>17</sup> Raporti i Parë, para. 30.

pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces ("VPP"), ku saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm.

10. Në pajtim me rregullën 113(2) të Rregullores, ZPV-ja regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon Gjykatësit të Procedurës Paraprake, së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe një kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit.

11. Në pajtim me rregullën 113(4)-(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka dhënë prova *prima facie* për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i një veprë penale të përfshirë në aktakuzë dhe nxjerr një vendim të arsyetuar me anë të të cilit miraton ose refuzon pranimin në proces. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos edhe për përfaqësimin e përbashkët, si dhe për çfarëdo kërkesë për masa mbrojtëse. Vendimi u njoftohet parashtruesit të kërkesës, ZPV-së dhe palëve.

#### IV. DISKUTIM

##### A. PLOTËSIA E KËRKESAVE

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij në vendimin kornizë, sipas të cilit një kërkesë është e plotë nëse përmbush këto kritere: (i) ka dëshmi të mjaftueshme të identitetit dhe, sipas rastit, të lidhjes familjare dhe/ose të kujdestarisë ligjore; (ii) të dhënat personale janë të plota; (iii) janë plotësuar të gjitha rubrikat përkatëse të formularit të kërkesës; (iv) janë treguar mjaftueshëm qartë data/periudha dhe vendndodhja e krimeve si edhe dëmi i pësuar; (v) është dorëzuar dokumentacion përkatës dhe i mjaftueshëm, për aq sa është e mundur; dhe (vi) kërkesa është nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës ose nga kujdestari i tij ligjor.<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup> Vendimi Kornizë, para. 22.

13. Duke marrë parasysh sa më lart ,Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vlerësojë nëse kërkesat e paraqitura janë të plota dhe nëse japin informacione të mjaftueshme për të mundësuar një konstatim sipas rregullës 113(4) të Rregullores. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kujton ZPV-së se duhet të bëjë përpjekje për t'i paraqitur Gjykatësit të Procedurës Paraprake vetëm kërkesa të plota.<sup>19</sup> Më tej, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e udhëzon ZPV-në që, kur një grup parashtruesish kërkesë të cilët kanë pësuar një dëm të ngjashëm si rezultat i drejtpërdrejtë i të njëjtit krim, siç është rasti i anëtarëve të një familjeje, përdor bashkërisht të njëjtin formular kërkesë, kriteret e kërkesës së plotë duhet të përmbushen, siç përcaktohet në paragrafin 12, për secilin parashtrues kërkesë.<sup>20</sup> Kur, pavarësisht nga përpjekjet më të mira të ZPV-së, një kërkesë nuk mund të plotësohet, ZPV-ja duhet gjithsesi t'ia paraqesë Gjykatësit të Procedurës Paraprake, duke treguar masat e marra për ta plotësuar kërkesën dhe arsyet e pasuksesshmërisë së tyre.<sup>21</sup> Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e udhëzon ZPV-në se kur, sipas mendimit të saj, një kërkesë dukshëm nuk ka lidhje me akuzat e konfirmuara, ZPV-ja gjithsesi duhet të sigurojë përmbushjen e kriterëve sipas pikave (i)-(iv) dhe (vi) të paragrafit 12.<sup>22</sup>

14. Sa u takon viktimave 01/05, 02/05 dhe 03/05, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se nuk janë përmbushur kriteret (i)-(iii), duke qenë se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dorëzuar asnjë dëshmi identiteti dhe lidhjeje familjare, të dhënat personale nuk janë të plota dhe disa rubrika të formularit të kërkesës nuk janë plotësuar.<sup>23</sup> Sa u takon kriterëve (iv) dhe (v), Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se parashtruesit e kërkesës japin disa informacione për periudhën dhe vendndodhjen e krimeve të pretenduara dhe bëjnë lidhjen me informacione të mëtejshme, por pa dhënë

---

<sup>19</sup> Vendimi Kornizë, para. 23.

<sup>20</sup> *Shih edhe* KSC-BC-2020-06, F00159, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë për kërkesat e viktimave ("Vendimi Thaçi e të tjerë")*, 4 janar 2021, publik, para. 17. Secilit parashtrues kërkesë në formularin e kërkesës të plotësuar bashkërisht i caktohet një pseudonim më vete.

<sup>21</sup> Vendimi Kornizë, para. 23.

<sup>22</sup> Vendimi *Thaçi e të tjerë*, para. 23.

<sup>23</sup> Shtojca 3, pjesët 1-2.

dokumentacion mbështetës.<sup>24</sup> Sa i takon kriterit (vi), Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se të tre parashtruesit e kërkesës e kanë nënshkruar formularin e kërkesës.<sup>25</sup> Megjithëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kërkesat e viktimave 01/05, 02/05 dhe 03/05 janë të paplota, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, në këto rrethana të veçanta, mund të bëhet një konstatim sipas 113(4) të Rregullores.

15. Sa i takon viktimës 04/05, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se nuk është përmbushur kriteri (i), duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi identiteti.<sup>26</sup> Sa u takon kriterëve (ii)-(v), Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të dhënat personale, si edhe rubrikat përkatëse të formularit të kërkesës, dhe ka dhënë disa informacione lidhur me dëmin e pretenduar të pësuar, së bashku me dokumentacion, por nuk ka treguar qartë datën dhe vendndodhjen e krimeve të pretenduara.<sup>27</sup> Sa i takon kriterit (vi), Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se parashtruesi i kërkesës e ka nënshkruar formularin e kërkesës.<sup>28</sup> Megjithëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kërkesa e viktimës 04/05 është e paplotë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se, në këto rrethana të veçanta, mund të bëhet një konstatim sipas rregullës 113(4) të Rregullores.

## B. PRANUESHMËRIA E KËRKESAVE

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimin e tij në vendimin kornizë sipas të cilit një viktimë që paraqet kërkesë pranohet të marrë pjesë në proces nëse ka prova *prima facie* se:

- (a) parashtruesi i kërkesës është person fizik;

---

<sup>24</sup> Shtojca 3, pjesa 2.

<sup>25</sup> Shtojca 3, pjesa 6.

<sup>26</sup> Shtojca 4, pjesa 1.

<sup>27</sup> Shtojca 4, pjesa 2.

<sup>28</sup> Shtojca 4, pjesa 6.

- (b) parashtruesi i kërkesës ka përshkruar në kërkesë veprime që duken se përbëjnë një krim brenda Aktakuzës së Konfirmuar;
- (c) parashtruesi i kërkesës ka pësuar personalisht dëm; dhe
- (d) dëmi ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>29</sup>

17. Sa u takon viktimave 01/05, 02/05 dhe 03/05, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se krimet e përshkruara nga të tre parashtruesit e kërkesës lidhen me ngjarje që kanë ndodhur disa vjet pas periudhës kohore të krimeve për të cilat janë ngritur akuza, janë në një vendndodhje që bie jashtë kuadrit gjeografik të të njëjtave krime të ngritura në akuza dhe nuk duket se lidhen me të akuzuarin.<sup>30</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kërkesat e viktimave 01/05, 02/05 dhe 03/05 janë të papranueshme.

18. Sa i takon viktimës 04/05, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se dëmi i përshkruar nga parashtruesi i kërkesës ka të bëjë me ngjarje tërësisht të palidhura me akuzat, asnjëra prej të cilave nuk duket se lidhet me të akuzuarin.<sup>31</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kërkesa e viktimës 04/05 është e papranueshme.

### C. MASAT MBROJTËSE

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se, nisur nga konfidencialiteti i procesit të paraqitjes së kërkesave, siç përcaktohet në rregullën 113(1)-(2) të Rregullores, dhe duke mbajtur parasysh mbrojtjen e privatësisë së parashtruesve të kërkesës, është e domosdoshme që emrat dhe të dhënat identifikuese të tyre të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut. Duke pasur parasysh se asnjëri prej

---

<sup>29</sup> Vendimi Kornizë, para. 28.

<sup>30</sup> Shtojca 1, f. 2-3; Shtojca 3, pjesa 2.

<sup>31</sup> Shtojca 2, f. 2; Shtojca 4, pjesët 2, 6.



parashtruesve të kërkesave nuk është pranuar si VPP, mospublikimi i të dhënave nuk cenon të akuzuarin apo gjykimin e drejtë.

20. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se klasifikimi i shtojcave duhet mbajtur rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* dhe, në çdo rast, urdhëron që emrat dhe çdo e dhënë identifikuese e viktimave 01/05, 02/05, 03/05 dhe 04/05 të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut.

## V. VENDIMI

21. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **RRËZON** kërkesat e viktimave 01/05, 02/05, 03/05 dhe 04/05 si të papranueshme; dhe
- b. **URDHËRON** që emrat dhe çdo e dhënë identifikuese e viktimave 01/05, 02/05, 03/05 dhe 04/05 të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E mërkurë, më 10 shkurt 2021  
Hagë, Holandë.